

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.452, date 9.7.2004

**PER KRITERET E DHENIES SE KREDISE PER STREHIM USHTARAKUT TE
FORCAVE TE ARMATOSURA TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE MASEN E
KESAJ KREDIE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 38 te ligjit nr.9210, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret per dhenien e kredise per strehim nga Ministria e Mbrojtjes ushtarakut te pastrehe apo me siperfaqe te pamjaftueshme banimi te Forcave te Armatosura jane:

- a. Grada e ushtarakut;
- b. Mundesite financiare per garantimin e kthimit te kredise;
- c. Renditja si me poshte vijon:

- (i) Ushtaraket aktive;
- (ii) Ushtaraket ne rezerve;
- (iii) Ushtaraket ne lirim apo pension.

2. Trajtimi me kredi per strehim behet nepermjet sistemit te kredive me fondet qe Ministria e Mbrojtjes siguron nga te ardhurat e veta.

3. Ministria e Mbrojtjes, per levrimin e kredise, mund te negocioje me bankat per arritjen e marreveshjeve ne kushte lehtesuese.

4. Per perfitimin e kredise, ushtaraku duhet te paraqese dokumentet si me poshte vijon:

Ushtaraku i pastrehe:

- a) Kerkesen personale;
- b) Çertifikaten e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- ç) Dokumentin e vertetimit te te ardhurave personale dhe te personave ne ngarkim te tij;
- d) Vertetimin se nuk ka pasuri te paluajtshme ne emer te tij apo te personave ne ngarkim te tij.

Ushtaraket qe kerkojne kredi per shtese te siperfaqes se banimit:

- a) Kerkesen personale;
- b) Çertifikaten e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- ç) Dokumentin e vertetimit te te ardhurave personale;

d) Aktin e pronesisë së banesës ekzistuese.

5. Kur ushtaraku e ndërton vetë banesën, duhet të paraqesë dokumentacionin sipas ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën", të ndryshuar.

6. Masa e kredisë të jetë si më poshtë vijon:

a) Për ushtarakun e pastrehe deri në 5 000 000 (pese miliona) leke, me interes 3 për qind dhe afat kthimi deri në 25 vjet;

b) Për ushtarakun që kërkon kredi për shtesë të sipërfaqes së banimit deri në 2 500 000 (dy miliona e pesëqind mijë) leke, me interes 3 për qind, afat kthimi deri në 15 vjet.

7. Kredia të shlyhet me keste mujor, i cili të mos jetë më i lartë se 30 për qind e të ardhurave mujore familjare.

8. Në strukturat e varesisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të ngrihen komisionet baze për dhenien e kredisë që në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim të shqyrtojnë dhe të përgatisin dokumentacionin e duhur për dhenien e kredisë ushtarakut, i cili i dërgohet për shqyrtim komisionit qendror për dhenien e kredisë.

9. Në Ministrinë e Mbrojtjes të ngrihet komisioni qendror për dhenie kredie, i cili pasi shqyrton dokumentacionin e përgatitur nga komisionet baze, propozon ushtaraket përfitues dhe masën e kredisë.

10. Komisionet e përcaktuara në pikat 8 e 9 të ngrihen me urdher të titullareve të strukturave përkatëse.

11. Lista emerore e ushtarakeve përfitues miratohet nga ministri i Mbrojtjes.

12. Ushtaraket që janë trajtuar apo do të trajtohen me kredi sipas vendimit nr.102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me strehim të funksionareve politike dhe të nepunëve civilë të administratës së lartë shtetërore", nuk përfitojnë kredi sipas këtij vendimi.

13. Vendimi nr.58, datë 23.1.2003 i Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me strehim të ushtarakeve të Forcave të Armatosura", shfuqizohet.

14. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2005.

**KRYEMINISTRI
FATOS NANO**

**MINISTRI I MBROJTJES
PANDELI MAJKO**